



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 14.7, të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, dt. 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, dt. 10. 09.2003, nenit 3, al. 1, pika “b”, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, al.1, pika “b” dhe nenit 40, al. 3, pika II të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2004 merr

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK-ZHVILLIMIT URBAN TË PRISHTINËS

Neni 1

Miratohet Plani strategjik-Zhvilimi urban i Prishtinës.
Plani, nga al. 1 e këtij neni përfshin periudhën prej vitit 2004 - 2020.

Neni 2

Plani, nga neni 1 i këtij Vendimi, përmban pjesën tekstuale dhe grafike.
Pjesa tekstuale e këtij Plani, përmban profilin e zhvillimit strategjik urban të qytetit të Prishtinës, analizën e gjendjes, parimet dhe caqet, kornizën e zhvillimit hapësinor si dhe strategjitë dhe veprimet për zbatim të këtij Plani.
Pjesa grafike e këtij Plani përmban të dhënat hartografike dhe shtojcat tjera grafike, në të cilat paraqiten gjendja dhe ndërhyrjet në hapësirë, tërësia e zgjidhjeve të planifikuara dhe territori që është përfshirë brenda kufijëve të këtij Plani.

Neni 3

Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të Planit, sipas këtij Vendimi, është promovimi i zhvillimit dhe planifikimit racional hapësinor, harmonizimi i drejtëpeshimit në mes të zhvillimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve të hapura, mbrojtjes së mjedisit dhe krijimit të regjimit të planifikimit urban në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 4

Bartës i hartimit të Planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, është Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Mbështetja profesionale në hartimin e këtij Plani është bërë nga insitutiet gjermane: **IWU**-Institut wohnen und Umwelt GmbH, **FEH**-Forschungs-und Entwicklungsgesellschaft Hessen mbH, **P4**-Planungsgruppe P4 GmbH dhe Instituti **INTECH**-Institut Teknologi-Prishtinë.

Neni 5

Mjetet financiare dhe mjetet e tjera të punës, të nevojshme për hartimin e Planit, sipas këtij Vendimi, janë siguruar nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Për zbatimin e Planit, sipas këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Organet tjera ekzekutive të Komunës së Prishtinës do t'i kryejnë veprime procedurale nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara me Statut për zbatimin e këtij Plani.

Neni 7

Zbatimi i këtij Vendimi do të bëhet përmes planeve rregullative, pëlqimeve në lokacion, lejeve urbanistike për caktimin e kushteve urbanistike-teknike për rregullimin e hapësirës dhe lejeve përkatëse për ndërhyrje në hapësirë, si dhe përmes formave të tjera të parapara me ligj.

Neni 8

Arsyetim të zgjeruar të këtij Vendimi paraqet pjesa tekstuale e Planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, e cila është pjesë përbërëse e këtij Plani.

Neni 9

Nga dita e miratimit të këtij Vendimi, pushon të vlejë Plan i përgjithshëm i qytetit të Prishtinës, i miratuar me Vendimin e ish-Kuvendit Komunal ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 32/88) si dhe të gjitha pjesët e parealizuara të planeve detale urbanistike të nxjerra në bazë të tijë, të cilat janë në kundërshtim me Planin e miratuar sipas këtij Vendimi.

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 031-1231/1 DT. 02.07.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri